Vendimi i PSSP-së për lëndët e Zhivko Zhivkoviçit (lënda nr. 28/08), Bozhidar Peroviçit (65/08), Arsenije Dimitrijeviçit (68/08), dhe Dragisha Aleksiçit (40/09)

Pas shqyrtimit të mendimit të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) për lëndët e Zhivko Zhivkoviçit, Bozhidar Peroviçit, Arsenije Dimitrijeviçit dhe Dragisha Aleksiçit, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm Lamberto Zannier, informoi PKDNJ më 18 gusht 2010 lidhur me rekomandimet e tij si vijon:

- Në lidhje me rekomandimin e Panelit dhe sa i përket çështjes së shkresës së Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut në shtator të vitit 2008, drejtuar gjykatave të Kosovës, UNMIK-u synon të kërkojë nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili ka marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë nga UNMIK-u në fushën e drejtësisë në Kosovë, që të koordinojë me autoritetet vendore përkatëse të Kosovës për të siguruar se janë marrë të gjitha hapat e mundshëm që lëndët e ankuesve në gjykatë të vendosen pa vonesë.

- Sa i përket rekomandimit të Panelit që ankuesve t'u jepet kompensim adekuat, Paneli është në dijeni se udhëzimet aktuale të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për kompensim, nuk lejojnë Organizatën e Kombeve të Bashkuara apo misionet e saj të paguajnë kompensime të tjera përveç atyre për dëme materiale apo për lëndime fizike. Prandaj, UNMIK-u nuk është në pozicion të paguaj kompensim për shkelje të të drejtave të njeriut që mund të jenë bërë kohët e fundit. Mirëpo, UNMIK-u do të vazhdojë ta drejtojë çështjen në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, me synim të tërheqjes së vëmendjes së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për nevojën e shqyrtimit të detajuar të rregullave të kompensimit që aktualisht janë në fuqi, që përjashtojnë pagimin e kompensimit për dëme jo-monetare.

- UNMIK-u gjithashtu, siç është rekomanduar nga Paneli, do të informojë ankuesit dhe Panelin për zhvillimet e mëtejshme lidhur me këtë çështje.